



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

14-020/04-135114/24, më 15 OCT 2024

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet themelimi i Komisionit për monitorim dhe kontrollim të raporteve të subvencioneve për Kulturë për vitin 2024 për përfituesit nga dy thirrjet:
- Thirrja e parë për kategorinë: Festivale, Muzikë, Manifestime, Kinematografi dhe Teatër,
  - Thirrja e dytë për kategorinë: Art Vizual - figurativ, Trashëgimi Kulturor dhe Turizëm, Shoqëri Kulturorë - Artistike, Mbështetje të organizatave vjetore dhe Operatoreve Kulturorë si dhe Botime.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, anëtarë të Komisionit janë:
1. Fatime Krasniqi - Financiere, Drejtorja për Kulturë, IMM-K-Prishtinë;
  2. Sadri Bahtijari - Zyrtar për Kulturë, Drejtorja për Kulturë;
  3. Drenusha Berisha - Zyrtare për promovimin e Turizmit, Drejtorja për Kulturë;
  4. Sebi Jusufi (anëtare rezervë) - Zyrtare për Kulturë, Drejtorja për Kulturë.
- III. Detyrë e Komisionit të cekur në pikën II të këtij Vendimi, është të bëjë monitorimin dhe kontrollimin e raporteve të subvencioneve për Kulturë për vitin 2024 për përfituesit nga dy thirrjet e renditura më sipër.
- IV. Komisioni për punën e tij i raporton Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Kulturës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

**I D O R Ë Z O H E T:**

- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
Përparim Rama

